



Pranuar / Dostigjen / Pamirren / Prizato / Received / Dostigjen		05.10.2022	2	viti god veçr
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org / Unit	Id / Prot Id / Prot Prot No	Shtojca Pulog Appendix	Sasia Kohetna Quantity	
SKOMSHIKV	5904/2022		1/3	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.809/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.809/2022 të datës 21.09.2022, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komuna e Drenasit, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.10.2022, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *Shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.809/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi - kandidat në Konkursin me numër Nr. 09-111/01-28939 të datës 20.06.2022 për pozitën mësimdhënës i lëndës së Kimisë në Komunën e Drenasit, më datë 21.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5540/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Drenas me Nr.09-111/01-35877 të datës 22.08.2022 si dhe vendimit të Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik me Nr.01-020/04-46910 të datës 06.09.2022 të komunës së Drenasit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5540/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes postës së Kosovës me datën 21.09.2022; Vendim i Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik me numër 01-020/04-46910 i datës 06.09.2022; Ankesë e ankuesit drejtuar Komisionit të ankesave në komunën

e Drenasit i datës 25.08.2022; Njoftim me numër protokolli 10-694 i datës 17.08.2022; Njoftim me numër protokolli 01-589/22 i datës 17.08.2022; Pliko me nr. R2365486 e datës 21.09.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë administrimit të provave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.809/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

**SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në Konkursin me numër Nr. 09-111/01-28939 të datës 20.06.2022 për pozitën mësimdhënës i lëndës së Kimisë në Komunën e Drenasit. I pakënaqur me rezultatin e kandidatës së suksesshme i njëjti me datë 25.08.2022, ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik, ndërsa ky i fundit me Vendimin me Nr.01-020/04-46910 të datës 06.09.2022 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit.

Kolegji i Këshillit lidhur me kompetencën lëndore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur për këtë çështje, ka konstatuar se sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 2 paragrafi 4, përcaktohet se: *“Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejtë për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, si rrjedhojë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të Arsimit Parauniversitar të Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, respektivisht pozita mësimdhënës nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.809/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesi*

Në kuptim të kësaj si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 4 dhe nenit 74 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet tek punëdhënësi pastaj mund të filloj kontestin administrativ në gjykatën kompetente, rrjedhimisht lidhur me mjetet juridike ka vendosur Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik përmes Vendimit me Nr.01-020/04-46910 të datës 06.09.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit, duke e udhëzuar palën e pakënaqur që kundër këtij vendimi mund të inicioj kontest pranë Gjykatës Kompetente.

Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.809/2022

**Çlirim ZEKA**

*Çlirim ZeKa*  
Procesmbajtës

**Eshref SHABANI**

*Eshref Shabani*  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

